



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1617/prot.,  
12

Tiranë, më 25.06.2026

VENDIM

Nr. 38, datë 24.06.2026

PËR

**“MIRATIMIN E PËRFITIMIT TË BURSËS STUDENTORE DHE PËRJASHTIMIT NGA  
TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT QË PREJ FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK  
2025-2026, PËR STUDENTEN SUADA AHMETI, E CILA STUDION NË NJË  
PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,  
TIRANË”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr.338/62 prot., datë 04.06.2026 “Mbi vlerësimin e kërkesës së një studenti, mbi përfitimin e bursës studentore dhe përjashtimit nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës studentore dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit që prej fillimit të vitit akademik 2025-2026, për studenten Suada Ahmeti, e cila studion në një program studimi të ciklit të parë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.



KRYETAR  
VANGJUSH STAVRO

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA ÖSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ